

AKT - THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE "Parkohu" SH.P.K

Neni 1- FORMIMI

Themelohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **"Parkohu"** Sh.p.k me Ortake znj. Rona Nushi, z. Rei Musabelli, z. Elton Nikolli, z. Medrit Kaimi, z. Denis Gidaja dhe z. Ledio Koçi

Neni 2 - SELIA

Shoqeria Tregtare **"Parkohu"** Sh.p.k. e ka seline ne: NJ.A. nr. 5, Rr. Pjetër Bogdani Nd 10, H 5, Apt 28, kati 7, 1019 , Tirane.

Neni 3 - KOHEZGJATJA

Shoqeria Tregtare **"Parkohu"** Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me afat te pacaktuar.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

- zhvillimin, menaxhimin dhe operimin e një platforme digjitale (aplikacioni dhe/ose faqe interneti) që ofron shërbime për gjetjen, rezervimin dhe pagesën e hapësirave të parkimit. Nëpërmjet kësaj platforme, përdoruesit mund të listojnë hapësirat e tyre të parkimit për dhënie me qira dhe/ose të kërkojnë, rezervojnë dhe paguajnë për hapësira parkimi të ofruara nga palë të treta.

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha aktivitetet ndihmëse dhe plotësuese për funksionimin e platformës, përfshirë por pa u kufizuar në: zhvillimin dhe mirëmbajtjen e softuerëve, administrimin e transaksioneve financiare, përpunimin e pagesave elektronike, integrimin me sisteme të palëve të treta, ofrimin e shërbimit të asistencës ndaj klientit dhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme që shërben për realizimin e qëllimit të saj.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare, industriale, shërbimi apo financiare, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj kryesor, si dhe të bashkëpunojë me persona fizikë ose juridikë brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria gjithashtu mund të kryejë, direkt dhe indirekt, të gjitha aktivitetet që përfshihen në objektin e saj si dhe të gjitha aktivitetet plotësuese që lidhen me të; të ndërmarrë të gjitha operacionet tregtare, industriale, ato që lidhen me pasuritë e tundshme, ato të patundshme dhe pasuritë financiare që lidhen me objektin e vetë shoqërisë. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me ndalimet, kufizimet, kushtet dhe autorizimet e parashikuara në ligj dhe në Statut.

Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare **"Parkohu"** Sh.p.k eshte 10 000 leke (dhjete mije), i cili do te shlyhet i gjithi nga Ortaket e Shoqerise. Kapitali perbehet nga 6 kuota.

Neni 6 - Administratoret

Shoqeria Tregtare **"Parkohu"** Sh.p.k. ka si Administrator te saj z. Elton Nikolli, shtetas shqiptar, i biri i Geg-es, lindur me 15.03.1991, ne Rubik dhe banues ne Tirane, ne adresën Rr. Siri Kodra Nr. 253; Njësia Administrative Nr. 8, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te

vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal J10315068Q, i cili emërohet ne kete funksion per nje periudhe prej 5 vitesh me kompetencat si ne vijim:

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Administratori i shoqërisë mund të lidhë kontrata me pale të treta deri në shumen prej 1 000 Euro/ operacion;

3. Administratori i shoqërisë ka të drejtë dhe kompetence të kryejë tërheqje cash / transfertë bankare për pagesa të ndryshme deri në shumen prej 1 000 Euro / operacion.

4. Për çdo veprim në shumën e lartë se sa përcaktuar në pikat 2 dhe 3 me sipër do të jetë e nevojshme firma e administratorit dhe njërit prej ortakëve të shoqërisë.

Administratorët mund të japin dorëheqjen ose të revokohen nga shumica e ortakëve në çdo moment.

Administratorët do të ushtrojnë të gjitha kompetencat e administrimit të përcaktuar nga dispozitat ligjore në fuqi

Neni 7- SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare “**Parkohu**” Sh.p.k. mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në Statutin e Shoqerise.

ORTAKE TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Parkohu” shpk

Rona Nushi

Rona Nushi


Rei Musabelli

Rei Musabelli


Elton Nikolli

Elton Nikolli


Medrit Kaimi

Medrit Kaimi


Denis Gidaja

Denis Gidaja


Ledio Koçi

Ledio Koçi
